



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/04-48224 dt. 23/09 2021

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
31.08.2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 31.08.2021

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.07.2021.
2. Buxheti i Komunës së Drenasit sipas kufijve dhe qarkores buxhetore 2022/02 për vitet 2022-2024
3. Propozim vendim i komisionit për emërtim të rrugëve.
4. Raporti i punës Janar-Qershor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
5. Diskutim i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
6. Diskutim i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2020.
7. Propozim vendim për ridestitim të mjeteve.
8. Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.
9. Propozim vendim për shqyrtimin publik i ndryshimeve të projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029.
10. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 30.07.2021 ishin: Kryesuesi Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari i Komunës Arben Shala, drejtorët e drejtorive komunale, shefi i kabinetit të kryetarit Flamur Curri.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoj të hapura punimet për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, ku prezantoi me rendin e ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ne e kemi edhe një propozim shtesë Propozim vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e tri (3) fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 965-0, zona kadastrale Nekoc, parcelën 614-0, zona kadastrale Kishnarekë, parcelën 910-0, zona kadastrale Tërstenik dhe një hapësirë rekreative sportive në parcelën 14-0, zona kadastrale Gllobar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës bashkë me piken që e propozoi kryetari Ramiz Lladrovci, si dhe me 7 pika tjera të cekura në rend dite me poshtë Propozim Vendime për financimin e Projektit, prezent gjatë votimit ishin:

29 anëtar dhe votuan me: 29 vota për, 00 vota abstenim, 00 vota kundër.

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.07.2021.
2. Diskutim i Buxheti të Komunës së Drenasit sipas kufijve dhe qarkores buxhetore 2022/02 për vitet 2022-2024
3. Propozim vendim i komisionit për emërtim të rrugëve.
4. Raporti i punës Janar-Qershor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
5. Diskutim i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
6. Diskutim i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2020.
7. Propozim vendim për ridestitim të mjeteve.
8. Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.
9. Propozim vendim për shqyrtimin publik i ndryshimeve të projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029.
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit "KF Feronikeli,,
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit "KH,Drenica,,
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit " KF,,Drenasi"
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit "K.Boksit,Drenasi"
14. Propozim Vendim për financimin e Projektit "Futsall Klubit,,LIQENI"
15. Propozim Vendim për financimin e Projektit "KVRL(Këshillit i Veprimit Rinor Lokal)"
16. Propozim Vendim për financimin e Projektit për projektin e Nazmi Hetës.
17. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e tri (3) fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 965-0, zona kadastrale Nekoc, parcelën 614-0, zona kadastrale Kishnarekë, parcelën 910-0, zona kadastrale Tërstenik dhe një hapsirë rekreative sportive në parcelën 14-0, zona kadastrale Gllobar.

Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për piken e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.07.2021.

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: 29 vota për, 00 vota abstenim, 00 vota kundër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Diskutim i Buxheti të Komunës së Drenasit sipas kufijve dhe qarkores buxhetore 2022/02 për vitet 2022-2024.**

Drejtori i Financave Shyqeri Bublatku- sipas ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë kërkohet që kuvendi Komunal të mbajë dëgjime buxhetore, sa i përket kategorisë së investimeve kapitale propozim vendimi i buxhetit për vitin 2022-2023 dhe 2024 mundemi me bërë ndryshime vetëm në kategorinë e investimet kapitale, qarkorja 22/02 i përcakton vetëm kufijtë e kategorive tjera, pagave, mallra dhe shërbime shpenzimeve komunale dhe subvencioneve ndërsa kategoria e investimeve kapitale jetë që kuvendi dhe dëgjimet që do t'i mbajmë t'i bëjmë ndryshimet të cilat të cilat mendon se janë më të mira apo projektet që mendojmë se do të implementime për vitin 2022, nuk është aprovim i buxhetit por vetëm me diskutu.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- ky debat për buxhetin është një debat që i hap rrugët e takimeve të asamblistëve me qytetar në të mirë të ndryshimit të çdo projekti që konsiderohet me nevoja apo që është në të mirë të çdo projekti që konsiderohet që me nevoja apo me interes për qytetar. Në rast se asamblistët organizojnë debate dhe mbajnë takime, në grandin e performances i shtojmë edhe tri pikë, pra ju vetëm se mundemi me mbajt takime me qytetar ju i rritni edhe piket komunës për garën për grand te performances.

Vehbi Berisha, mire është bërë që kësaj radhe po behet ky dëgjim buxhetor, kemi mundësi me diskutu, por edhe me herët kemi pas mundësi me i adresu çështjet tona, edhe nga hera e kaluar është duke u bërë një lëshim me qellim, ne e kemi mirëkuptuar komunën që nuk është e lehtë me zhvillu shumë procedura të tenderëve, prandaj kemi lejuar që me u grumbulluar me një kod buxhetor, por se paku u dashtë me i ditë kur themi asfaltimi i rrugëve, tash kanë emra ta dina për çka po marrim vendim, sot mungon kjo, e kam cek edhe me herët këtë çështje mirëpo nuk po merret parasysh, ligjërisht ki të drejte, të faqe 2 te investimet kapitale deshta me adresu një çështje është një kod këtu që thotë: instalimi i ndriçimit të ri dhe riparimi i rrjetit dhe ndriçimit publik ekzistues i Komunës së Drenasit kodi ishte 492293, ndërsa edhe një kod tjetër ku thotë rregullimi i infrastrukturës, ndriçimi publik në Komunën e Drenasit, pse këto dy kode kur ne thelb po duket që është e njëjta gjë. Kodi tjetër është nr 48661 Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas këtu janë akorduar disa mjete në shumë prej 376 mije euro a është fjala për te njëjtin projekt apo diçka tjetër? Projekti tjetër 492429 që ka të bëjë me një premtim tendin kur kanë qenë fushatat hartimi i projektit të fiziobilitetit të nxemjeve qendrore që mund me u shfrytëzua uji i nxet i feronikelit, e shikova që edhe mjetet që kanë qenë për këtë çështje i kishi ridestinu tjetër kund.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- tenderët që janë kanë më nga 200-300 metra e që ishin nga 250-60 tender nuk janë më i kemi grumbulluar në infrastrukturë rrugore, kanalizime në investime të ndryshme i kemi grumbulluar në më pak kode, kodi 492293 janë dy kode të veçanta njëra është për ndriçim dhe tjetra është për investime kapitale të ndriçimit, pra janë dy projekte kapitale, e kemi zhvilluar këtë projekt bukur shumë ku dhe po e shtojmë sigurinë të qytetareve duke bërë ndriçime në fshatra, lagje e qytete. Sa i përket kodit të ujësjellësit, unë e kam gjet kodin e ujësjellësit që nuk kanë qenë fare gypat që është paguar dy herë nga komuna, dhe nuk e keni ngrit zërin asnjëherë, unë e kam ngrit në prokurori këtë çështje, dje

ka qene aktakuza mirëpo nuk ka mundur me u zhvillu për arsye se njeri nga të akuzuarve ka qenë me covid 19, por ne do t'i zhvillojmë prape këto projekte, këto mjete që janë të parapame janë për rrjet të ujësjellësit ku do të punojmë në furnizim të ujesjellesit me uje te pijes, nga bazeni i Kamenices rrjeti i ujesjellesit që te dergojne ne fshatra te ndryshme, sipas informacioneve pasi ta mbushim bazenin me uje do ta vertetojme se a ka gypa ne tok apo nuk ka gypa ne tok. Sa i përket nxemjeve qendrore, e kemi thene e kemi premtu dhe e kemi thene nxemja qendrore do te instalohet ne mandat 8 vjeqar edhe ne rast qe kam thene 4 vite po do te realizojme, kemi thene që do ta vendosin prej feronikelit e kemi konstatu që nuk ka uje te ngrohtë të mjaftueshem sepse uji del diku 22 grad.

Sabrije Kukaj- e shikova buxhetin, disa sqarime , psh vazhdim ne fshatin Verboc 30 mijë euro për vitin 2022, Polluzhë, Shtuticë, por kisha kerku që nje pjese e rruges ne lagjen Rrukiqi nga shtrati i lumit janë dy familje që rrugen që kalojne është shumë e ngushtë dhe është e shtruar me zallë dhe është shume keq, nje pjese e ketyre mjeteve te vitit 2022 apo keto që kane mbet shkojnë në atë rrugë. Me vjen mirë që 200 mije euro jane ndarë për ujesjelles për gypat e ujëslljesit. 10 mije euro për kanalizim te ujerave te zeza në Drenasin I,II,III,VI në Drenas është shumë pak. 170 mijë euro në infrastrukturë në Drenas po mendoj se është e mjaftueshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- sa i perket gypave që i ka prere autostrada apo i ka prish Polluzhe-Gllobar ne e kemi pas nje takim me kryeshefin ekzekutiv te ujesjellesit nivel rajonal në Prishtinë bashk me nenkryetarin dhe drejtorin e infrastruktures Endrit Gllareva, e kemi ngrit jo vetem këtë qeshtje po i kemi ngrit shume qeshtje tjera, ai është një projekt i CDI-së ku buxheti është i Kosovës dhe i Komunës të cilin e kanë implementu përmes kompanisë të ujësjellesit rajonale nuk jemi ne pergjegjes, ne kemi kerkuar që ata me kerku, nese Ministria e Infrastruktures ia ka dhënë lejen me vendos gypin e kanë për obligim edhe kur ta prishin me e rregullu, edhe per gypin prej Drenasi-Zabel në Drejtim të Komoranit nuk i kemi vendos derisa na kanë dhënë lejtën, tani jemi duke e vendos. Sa i përket ndotjes se lumit, ndotja e lumit jo vetem tek në por është ne gjithë Kosoven, prandaj jemi komuna e parë në Kosovë që i kemi vendos kolektoret perrreth brixheve të lumit por ende nuk janë në funksion sepse pa perfundu projekti ne nuk mundemi me hy në funksion, rruga të lagja Rrukiqi me sa duket këtë vit edhe ajo kryhet, sa i përket degjimeve publike i kemi para vete propozimet të cilat kanë dal nga kerkesat e qytetareve në degjime publike, sa i përket komestacionit nuk kemi të drejtë me i shtru ato rrugë, krejt shkresat e mundshme kërkoj, kërkon qasje në dokumenta, gjitha shkresat e mundshme ia kam derguar qeverise dhe kuvendit që me e bërë një zgjidhje për zonat qe janë ndertuar në zonat me komostacion, me na dhënë një mundesi, qdo shtëpi që është ndertuar dhe u bë e banueshme edhe me dasht me e rrzu nuk na lejon ligji, kemi të drejt ku është pronë publike, ku pëngon në projekte

Sabrije Kukaj, duke e ditë që qdo 10 vjet rishikohet harta e qytetit, a ka mundesi që Kuve ndit Kosovës me ia dergu nje elaborant me u kthy toka ndertimore.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ne e kemi diskutuar me GIZ-in gjerman që ata po na ndihmojnë që i falenderoj publikisht, e kemi hedh në diskutim nuk lejohet, pra nuk lejohet as me bë elaborant, as me bere planifikim as me shpallë zonë ndertimore, vetem Kuvendi i Kosovës i cili ka të drejte me nderru destinimin e pronës të sistemit iberlepencit, i kam shkruar qeverisë i kam shkruar gjitha instutucioneve të mundshme me na zgjidhë këtë qeshtje, pres që të zgjidhet sa ma shpejt.

Sokol Bylykbashi- me vjen mirë që e kemi propozimin për buxhet dhe është hera e parë që mbajme një seancë të veqantë ku si diskutim është buxheti para se me u thirrë një seance

tjeter ku do të votohet perfundimisht, mdaj mend që e kam pas cek edhe nje herë që për vendime të rendesishme siq është buxheti apo vendime tjera është mirë me u mbajt seanca të tilla shqyrtuese dhe me karakter diskutimi pa miratim. Besoj pajtohemi të gjithë infrastruktura në përgjithësi është baza e zhvillimit dhe na ne bazë nuk jemi mirë, mjafton vetem me i shiku disa rrugë qoftë qytet qofte edhe naper disa fshatra, del në rrugë dhe i afrohesh një shkolle ku ka kryqezime të shkolla, pra aty nuk sheh trotuar, tjeter nuk ka shenja komunikacionit që është shkolla, apo ndonje penges për ndalim të shpejtesisë edeh ajo mungon, tjeter qeshtje kanalizimi, mungesa e ujit, lumi “Drenica” është ne gjendje të tmerrshme, ne buxhetin e fundit ne ju kemi thene edhe me i perfundu procedurat ashtu siq ju doni por edhe me u kuptu se qka po votojme, prap e keni përmend asfaltim i rrugës tri kater fshatra rend nuk dihet as rruga sa asgjë, ajo qka duhet me investu në Komunën e Drenasit është trotuari i cili ka nevojë shumë, ka nevojë me punu me ujësjelles shumë, ka nevojë në kanalizim me punu në mënyrë urgjente kjo është baza, ka nevojë me punu edhe në segmente tjera që kemi mbet mbrapa.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- keto që po i thua ti janë të gjitha të paverteta, për kryqzime the që nuk ka sheja të komunikacionit afer shkollave të gjitha këto janë të pavërteta, ne e kemi zënë vendin e parë për sinjalistikë në Kosovë e cila u diskutua edhe në parlament kjo qeshtje keshtu që ne jemi më të miret në Kosovë nuk jemi vetem për performace por jemi edhe për këto qeshtje sepse kemi zenë vendin e parë dhe është raportuar edhe në Kuvendin e Kosovës, nga tani e deri në tetorin e 2025 nuk investoj nuk ndertoj ne prona private aty ku nuk mundem me vendos trotuar aty ku është prona private sepse jemi duke larë borgj, ku jane ndertuar në prona private janë hap trase ne prona private pa i shpallë në interes të përgjithshem.

Beqir Kiqina, sa përket propozimit të buxhetit për vitin 2022 kisha kërkuar një sqarim nga drejtori i shendetesisë, sektori i shendetesisë parashihet të këtë buxhet prej 2.84.614 € per vitin e ardhshem, duke parë parasysh se jemi ne një vit të pandemisë ndersa ky vit ka rezultu edhe me keq se sa viti i kaluar me pandemi, duke qenë kritik edhe nga niveli qendror, ndersa edhe niveli lokal nuk është mirë, duke e shikuar që edhe QMF-ja “Hafir Shala” në Drenas nuk i ploteson kushtet për gjithë ata qe kerkojnë trajtim në shendetesi kisha dasht me ditë që komuna a ka aloku mjete nga kjo shumë edhe për vitin e ardhshem për shkak se demet psh që shkaktohet këtë vit me i mbulua vitin e ardhshem, dhe duke parë parasysh që qendra duhet të furnizohet me barnat e nevojshme mjeksore, dhe është në kushte jo të mirë hixhenike dhe sanitare.

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku- sa i përket buxhetit për vitin 2022, të QMF-së në Drenas, dihet që buxheti ndahet në tri kategori sektorin sektori i arsimit, i shendetesise dhe sektori i administates, sektori i shëndetësisë dhe sektori i administrates e kanë buxhetin specifik dhe shuma përcaktohet nga niveli qendror nuk është qe ne e kemi përcaktuar atë shumë por është e caktuar nga niveli qendror, dhe këtu paraqiten të gjitha investimet, pagat mallra dhe sherbime, komunalit, grandit specifik i shendetesisë e ka paraparë nga niveli qendror shumën prej 2 milion e 88 mijë euro, duke perfshi edhe 32 mijë euro të hyra vetanake të cilat i realizon drejtorja e shendetesisë.

Nexhmedin Balaj- sa i përket infrastruktures ne te gjitha fshatrat ne Komunën e Drenasit thuajse vetem 5 % nuk jane te asfaltuara, dhe shumica e fshatrave janë të shtruar edhe me trotuar, sa i përket, sa i përket infrastruktures rrugore u dasht me ardh me shifra të sakta sa shtepi te banuara janë të pa asfaltuara, ne fshati'n Korroticë e Eperme deri ne vitin 2009 nuk e kemi pas te shtruar as edhe nje meter asfalt tani vetem 5 % mundemi me thënë që jane te

pa asfaltuara, në infrastrukturen sportive e kemi një stadium shumë modern ku po kalon shifra me miliona euro.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- sa i përket kërkesave tua, ne i kemi me shifra të sakta ne i kemi bërë ne raporte 6 mujote të kryetarit, sot e kemi mundësinë me fol për buxhetin.

Adem Bucolli- e kam një propozim nga lagjia e Xhamisë e deri në Poklek të Vjeter e kemi kërkuar një trotuar dhe ndriqimin e rruges nese është e mundur.

Pasi që kjo pikë ishte vetëm diskutim, atëherë kryesuesi vazhdoi me piken tejter të radhës 3. Propozim vendim i komisionit për emërtim të rrugëve.

Petrit Gashi- Faleminderit Kryesues, i nderuar kryetar, Të nderuar kabinet i kryetarit. Shumë të respektuar koleg dhe kolege të asamblesë Komunale në Drenas. Në shqyrtim të Propozim Vendimit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në Komunën e Drenasit, me lejon që para së të ju njoftoj për punën tonë të falënderoj të gjithë ata që kontribuan në realizimin e punës tonë. Se pari një falënderim anëtarëve të komisionit për punën dhe përkushtimin e tyre në një periudhë të vështirë të pandemisë ku kemi bredhë rruge me rruge sipas kërkesës së qytetarëve për të vizituar dhe me pas për të vendosur për emërtim, e në këtë rast falënderoj kryetaren e Komisionit Kimete Bardhi, anëtarët: Bekim Lestrani, Burim Bujupi e Gentrit Gerguri. Po ashtu në emër të komisionit një falënderim edhe për të gjithë administratoret e fshatrave, përfaqësuesit e lagjeve dhe të gjithë parashtruesit e kërkesave për një bashkëpunim të sinqertë sa i përket punës së këtij komisioni. Të nderuar anëtarë të kuvendit, Gjatë punës tonë, që nga funksionalizimi i këtij komisioni kemi mbajtur gjithsej 47 takime ku 43 prej tyre i kemi zhvilluar në teren për të verifikuar kërkesat e qytetarëve drejtuar këtij komisioni lidhur me emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në Komunën e Drenasit. Që në takimin e parë Komisioni është pajtuar dhe ka marrë vendim që të gjitha kërkesat që i posedon të verifikohen në teren dhe të shikohen për se afërmi se a i mbushin kushtet sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, dhe kriterëve të vena nga komisioni, dhe gjithashtu kemi vizituar secilin fshat dhe lagje në komunën e Drenasit, shpesh edhe me shumë së njëherë. Me shfaqjen e Pandemisë jemi detyruar që sipas masave të vena nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ta ndalim punën për daljen në teren për shkak të distancës sociale, dhe respektimin e vendimeve të vena nga Qeveritë. Megjithatë kohë pas kohë jemi munduar që në bashkëpunim me administratoret dhe parashtruesit e kërkesave të trajtojmë secilën kërkesë dhe ta vizitojmë në vend secilën rrugë apo rrugice që është propozuar për emërtim. Jemi munduar që të shmangim keqkuptimet dhe njëkohësisht të ju shpjegojmë qytetarëve bazën ligjore dhe kriteret për emërtimin e rrugëve, dhe besoj bashkërisht kemi arritur që të vijmë në përfundim ku përmes rekomandimeve të këtij raporti ta procedojmë për votim sot këtu. Gjatë punës tonë kemi vizituar 1362 rrugë dhe rrugica të ndryshme në fshatrat e komunës së Drenasit duke i shqyrtuar 353 kërkesa të qytetarëve dhe administratoreve lidhur me këtë komision. Ne, në raportin që ju kemi rekomanduar për votim i kemi përcjell edhe numrat e të gjithë kërkesave se bashku me propozimet në mënyrë që të jemi transparent dhe të kemi me të qartë së për cilën rrugë apo rrugice behet fjalë. Përveç propozimeve për emërtim, brenda në raport ne kemi bërë edhe arsyeshmerine ligjore të marrjes së vendimit të secilit propozim veç e veç në mënyrë që të ju mundësohet edhe ju për të verifikuar me lehtë propozimin tonë. Prandaj krejt në fund ne kemi paraqitur edhe ne harta në secilin fshat emrat e propozuar, në mënyrë që të ju mundësohet punë me e lehtë edhe administratës për t'i futur në sistem por edhe ju për të parë së për cilin propozim bëhet fjalë, dhe këto harta janë të bashkangjitura në fund të raportit. Të nderuar

koleg dhe kolege përgjatë gjithë kësaj kohe, me besimin të po të këtij kuvendi kemi verifikuar për se afërmi kërkesat e qytetareve dhe për 43 ditë në teren në këtë periudhë kemi qëndruar pa kompensim vetëm e vetëm që punën tonë ta kryejmë sa më mire dhe ti shmangim problemet e mundshme. Të gjithë ato propozime që ju kemi rekomanduar përmbajnë edhe qëndrimin e qytetareve në pajtueshmëri me vullnetin e shumicës të cilët jetojnë në atë rrugë ku është propozuar. Pjesa tjetër, në të cilën kanë pasur konteste apo mospajtime mes vete jemi dakorduar se pas gjetjes së zgjedhjes në mes tyre të bëjnë kërkesën dhe ti drejtohen përsëri komisionit. Duke shpresuar së ashtu siç na dhatë besimin si komision për të marrë këtë përgjegjësi, edhe sot do na mbështetni në propozim vendimin për emërtimin e rrugëve që ju kemi sjellë para vetes, mirëpo në këtë rast kërkoj nga ju ti merrni parasysh disa gabime të vogla teknike e të cilat janë: Një gabim teknik të një emër rrugë ku nga FATIME FENIKU ashtu siç e keni në material bëhet FATIME SENIKU, pra një shkronje që është bërë si gabim, dhe shtim edhe i një emri që kemi verifikuar tani në proces të përfundimit të raportit e që i shtohet këtyre rekomandimeve e që është emërtimi me emrin ZEQIR HALILAJ që ka ardhur sipas kërkesës 12-070-5568. Gabimi tjetër teknik ku nga emri Lah Zariqi si e keni në material behet Bislim Zariqi dhe një emër Daut Hoti largohet nga lista për emërtime sepse nuk i plotëson kushtet pasi në rrugën në të cilën është shënuar nuk ka asnjë objekt dhe nuk përfaqëson vullnetin e lagjes. Edhe njëherë ju falënderoj shumë dhe ju ftoj ta votoni me këto ndryshime këtë propozim vendim!

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, e falënderoj komisionin për punën që e kanë bërë dhe angazhimin që e kemi pas, e cila nuk ka qenë e lehtë me e diskutuar qeshtjen e emërtimit të rrugëve, besoj që e keni bërë ma të mirën e mundshme, sigurisht po diskutojmë për emërtimet e reja, qdo emërtim që është bërë këto 10 vitet e fundit pa kaluar 10 vite emërtimi me ligj nuk mund të ndryshohet, nuk ka të drejtë të ndryshohet.

Adem Bucolli, e përgezoi komisionin për raportin e detajuar dhe për punën që e keni bërë, e kam një propozim në bashkëpunim me fshatin dhe me administratorin e fshatit kemi vendos që nga shtëpitë tona kemi vendos që rruga me u emërtu Bucolli sepse janë vetëm shtëpitë tona dhe rruga jonë, ketu e kam edhe kërkesën dhe të nënshkruar nga administratori dhe përfaqësuesit e lagjes.

Petrit Gashi- ashtu siç kërkoja që disa gabime teknike me u përmirësuar kërkoj që edhe ky propozim me u miratuar, kërkoj që edhe ky propozim me u përfshi në këtë pjesë dhe me këto ndryshime me e votu propozimin.

Sokol Bylykbashi- ka qenë mirë për qdo emërtim të ketë një përshkrim të atij personi që e kanë emërtuar atë rrugë.

Nexhmedin Balaj- do të ishte mirë që për qdo emërtim të ceket se paku një biografi e shkurtër për secilin person që është emërtuar rruga.

Petrit Gashi- në raportin përmbledhës prej 400 faqeve në përveq propozimeve për emërtim të rrugëve në e kemi bërë edhe numrin e kërkesave të qytetareve, nëse janë bërë 4 kërkesa në i kemi përfshi të gjitha, dhe secili kolegj i joni ka mundur me e verifikua kërkesën nëse ka dasht me ditë për historiatin e tij apo si ka ardh deri të propozimi, ose edhe për peticionin që qytetarët janë drejtuar.

Pas diskutimeve Kryesuesi Labinot Halilaj hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me ndryshimet që u ceken me lartë, prezent gjatë votimit ishin
Për votuan 27 anetar, 1 abstenim, 00 kunder.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën:4 .Raporti i punës Janar-Qershor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.

Sokol Bylykbashi- kur flasim për punën në komune kemi dy lloje të raporteve ,është raporti i ekzekutivit që paraqet të arriturat sukseset punët ,por edhe raportin e zyrës se auditorit të përgjithshëm ku shfaq gjetje ,shkelje edhe rekomandime po e përmendi 24 projekte që kane qenë pa plan për shkak se nuk e kanë bërë planin si duhet d.m.th ka shkelje me dash apo pa dashje ato ndodhin pavarësisht asaj që thoni që nuk ka ,edhe pse kryetari e ka konfirmuar se në fund të raporti ai e konfirmon që pajtohet me të gjitha rekomandimet .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-sa i përket raportit të auditorit raportin me të mirin prej raporteve në Kosovë e kemi as nuk kam thanë asnjëherë që ne jemi të pa gabueshëm as nuk bëjmë shkelje, çdo shkelje me qëllim a paqëllim shkelja është shkelje ,ne e kemi formuar komisionin për implementim dhe ia kemi dërgua auditorit unë jam mirënjohës përket raport për çdo njërin zyrtar .

Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku- sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të Komunës se Glllogocit prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtet që prezantojnë aspekte materiale ,në përputhje me standardet ndërkombëtare te kontabilitetit për sektorin publik sipas kontabilitetit te bazuar ne para të gatshme ky është opinionin i zyrës kombëtare të auditimit është e vërtet qe ka vonesa sepse ka qene vit pandemik dhe ka qene e pamundur mos me bërë shkurtim të procedurave mirëpo kjo kishte me qenë sa i përket kësaj pikë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi për diskutim pikën 5.Diskutim i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Për këtë pikë nuk pati diskutime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi për diskutim pikën 6.Diskutim i Planit të Veprimt për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2020.Edhe për pikë nuk pati diskutime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi për diskutim pikën 7.**Propozim vendim për ridestininim të mjeteve.** Me qenë se edhe për këtë pikë nuk pati diskutime, kryesuesi hedhi në votim pikën 7.**Propozim vendim për ridestininim të mjeteve.**

Për votuan 17, abstenime 2 ,kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi për diskutim pikën 8.Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.

Sokol Bylykbashi-siç e dimë të gjithë jemi ne fund të këtij mandati dhe kryetari nuk ka kompetenca me shtyre përpara vendime të rëndësishme siç ato me pronat publike respektivisht dhënien ne shfrytëzim te tyre kjo liste nëse është listë që ndihmon diçka në kuptimin juridik që i paraprin këtyre proceseve atëherë pra kjo tregon që është ndesh me atë që e thash unë nëse është listë që nuk ka ndonjë impakt juridik për proceset që do të zhvillohen në këtë drejtim atëherë i bëjnë që është listë kotë ,normal që kjo listë d.m.th. diçka kjo listë tregon planet që ka kryetari për pronat publike, dhe unë në parim jam që pronat komunale të pa shfrytëzuara të jepen ne shfrytëzim të gjithë atyre që dojnë me i zhvilluar veprimtarit e tyre biznese për shkak se edhe i mbajnë familjet rritet numri i të punësuarve ,dhe tokat nuk mbesin djerrin po ashtu edhe i rritet vlera pronës, por dokumenti tregon vetëm parcela me numra d.th.m ne nuk e dimë ku janë ,mund ta din kryetari ,drejtori dhe zyrtaret e

drejtorisë përkatëse ,është dashur lista e pronave të ketë edhe me shumë dokumente që e sqarojnë me saktësisht se ku gjenden ato prona ,sa i përket pronave publike komunale në bërthamë të Drenasi unë e kam jep mendimin tim dhe e dini ,pra unë nuk jam që ato prona me u jep ashtu do si do për ndërtime të larta me përfituar dikush dhe me u thirr në interes të qytetareve ky është qëndrimi im.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- unë e kam obligim ligjor me e bërë listën e pronave që mund të jepen në shfrytëzim në vitin e ardhshëm nuk e kam obligim ligjor me sjell në kuvend në këtë fazë por, për me qenë sa me transparentë e kam sjelle këtë dokumente me pronat me numrat e parcelave që mund të planifikohen të jepen në shfrytëzim vitin e ardhshëm.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hedhi në votim pikën 8.Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.

Për votuan 16, abstenime 0 ,kundër 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi për diskutim pikën 9.Propozim vendim për shqyrtimin publik i ndryshimeve të projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029. Diskutime nuk pati diskutime, kryesuesi hedhi në votim pikën e nëntë të rendit të ditës ,dhe kjo pikë kaloi në mënyrë unanime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi për diskutim pikat 10.**Propozim Vendim për financimin e Projektit "KF Feronikeli,**

11. Propozim Vendim për financimin e Projektit "KH,Drenica,,
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit " KF,,Drenasi"
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit "K.Boksit,Drenasi"
14. Propozim Vendim për financimin e Projektit "Futsall Klubit,,LIQENI"
15. Propozim Vendim për financimin e Projektit "KVRL(Këshillit i Veprimit Rinor Lokal)"
16. Propozim Vendim për financimin e Projektit për projektin e Nazmi Hetës.

Sokol bylykbashi –për dallim prej herëve tjera ka një game me të gjerë të përkrahjes për klube dhe kjo është mirë ,mirëpo e pash edhe një subvencionim për një trajnim të një gazetari që nuk munda me e kuptua 500 € me duket ke vlera .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-ju i votoni vetëm ato që e kanë shumën mbi 1500 € që është obligim i kuvendit ato me shume me të vogël mund ti nënshkruaj kryetari.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hedhi në votim pikat 10. **Propozim Vendim për financimin e Projektit "KF Feronikeli,**

- 11.Propozim Vendim për financimin e Projektit "KH,Drenica,,
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit " KF,,Drenasi"
- 13.Propozim Vendim për financimin e Projektit "K.Boksit,Drenasi"
- 14.Propozim Vendim për financimin e Projektit "Futsall Klubit,,LIQENI"
- 15.Propozim Vendim për financimin e Projektit "KVRL(Këshillit i Veprimit Rinor Lokal)"
- 16Propozim Vendim për financimin e Projektit për projektin e Nazmi Hetës.

Të gjitha këto pikat e cekura me lartë u votuan në mënyrë unanime

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi për diskutim pikën 17. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e tri (3) fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 965-0, zona kadastrale Nekoc, parcelën 614-0, zona kadastrale Kishnarekë, parcelën 910-0, zona kadastrale Tërstenik dhe një hapësirë rekreative sportive në parcelën 14-0, zona kadastrale Gillobar.

Pasi nuk pati diskutime edhe këtë pikë kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj- hedhi në votim. Për votuan 16, abstenime 2, kundër 0.

Mbledhja përfundoj rreth orës 11:12 min

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi

Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Labinot Halilaj